

## **AGRON MAKSUTAJ**



Auditues i Parë në Departamentin e Kontrollit të Investimeve të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Lindur më 1949. Diplomuar në Agronomi (1973).

40 vite eksperiencë pune. 13 vite pune në KLSH.

Fusha e ekspertizës: Auditimi i Privatizimeve dhe Mjedisit

### **PËR NJË AUDITIM MJEDISOR CILËSOR<sup>iii</sup>**

nga Agron Maksutaj

Gjatë auditimeve të kryera nga KLSH në Drejtorinë e Shërbimit të Pyjeve në Lezhë, Dibër dhe Pukë është konstatuar se ato nuk janë të organizuara dhe nuk funksionojnë në përbërje të drejtorive rajonale të shërbimit pyjor. Megjithatë, këto drejtori janë shumë të rëndësishme për fondin pyjor të vendit, këtë pasuri të jashtëzakonshme kombëtare. Drejtoria e Shërbimit të Pyjeve në Lezhë disponon një fond pyjor prej 3052 ha, ose 11.8 % ndaj totalit të përgjithshëm të fondit pyjor. Drejtoria e Shërbimit të Pyjeve në Dibër disponon një fond pyjor prej 21,195 ha, ose 49.2% ndaj totalit të përgjithshëm. Pyjet shtetëror që administron Drejtoria zënë 38% të totalit të përgjithshëm. Ndërsa Drejtoria e Shërbimit të Pyjeve në Pukë administron rreth 50% të fondit të përgjithshëm pyjor dhe kullësor të rrethit. Si të tilla, këto subjekte me aktivitetin dhe ngarkesën që kanë nuk janë efëçente dhe ekonomike, sepse produkti që ato japin është i paefektshëm dhe i pamatshëm pasi mungojnë objektivat dhe synimet e shpallura nga këto drejtori. Ato nuk kanë të shpallur objektiva afatmesme dhe plane veprimi vjetore, bazuar në programet e zhvillimit të sektorit të pyjeve dhe kullotave për ruajtjen,

administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e fondit pyjor të tokës pyjore dhe burimeve natyrore e biologjike që ato disponojnë. Ato nuk janë kryer në përputhje me nenin 6 pika 2 shkronja a të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin pyjor”, funksionin menaxhues si një nga dy funksionet e shërbimit pyjor, për mungesë dhe për mos zbatimin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave pasi zbatimi i tyre do të bënte të mundur qeverisjen teknike të tyre si më poshtë:

- Zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullosor;
- Ruajtjen dhe krijimin e kushteve natyrore për gjallesat pyjore dhe komunitetet e tyre;
- Mbrojtjen, trajtimin dhe kryerjen e punimeve sivilikulturore e të tjera punime që sigurojnë plotësimin në kompleks të funksioneve të pyllit;
- Mbarështimin e pyllit dhe të tokës pyjore për të ruajtur funksionet e tyre dhe shkallën e ruajtjes të mjedisit pyjor;
- Planet e mbarështimit të pyjeve dhe kullotave në administrim të DSHP-ve, janë të tejkaluara në kohë pasi janë hartuar para viteve 1985 dhe nuk kanë vlerë aplikative për zbatim.

Këto drejtori, si shumë simotra të tyre në rrethe të tjera, nuk kanë realizuar ruajtjen dhe rehabilitimin e fondit pyjor në administrim të tyre, si dhe trajtimin dhe shfrytëzimin e fondit pyjor kombëtar në veçanti të fondit pyjor. Nga buxheti nuk u janë planifikuar fonde për hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, me gjithë kërkesat e bëra në mënyrë të vazhdueshme nga drejtorit përkatëse të shërbimit pyjor. Po ashtu Buxheti i Shtetit nuk ka planifikuar fonde për asnjë nga vitet e fundit në zërat: investime (mbjellje të reja etj), për rimëkëmbjen e integritetit ekologjik të pyjeve, për ruajtjen dhe përmirësimin e eko-sistemeve të habitateve dhe të gjendjes mjedisore, etj. Një e metë tjetër është se nuk është planifikuar shfrytëzim lënde drusore në pyjet që ju ka kaluar mosha e shfrytëzimit duke

bërë që të ulet vlera komerciale e tyre. Si në 1160 ha në rrethin e Dibrës (610 ha pyje shtetëror dhe 550 ha pyje komunalë), etj.

Si përfundim, një nga funksionet dhe detyrimet e Drejtorive të Shërbimit të Pyjeve (DSHP), ai menaxhues nuk është përmbushur pasi qeverisja teknike e pyjeve dhe kullotave duhet të bëhet sipas planeve të mbarështimit.

Në paketën ligjore aktuale konstatojmë se:

- Nuk ka mekanizma ligjor auditues dhe monitorues mbi verifikimin e zbatimit të planeve të hartuar për fondin pyjor në pronësi publike të miratuara për zbatim, si dhe nuk ka përcaktime ligjore për nxjerrjen e përgjegjësive administrative për moszbatim të tyre duke gjykuar se për hartimin e këtyre planeve janë dhe do të përdoren shuma të konsiderueshme monetare.
- Nuk ka mekanizma ligjorë që do të kontrollojnë dhe monitorojnë zbatimin e planeve të veprimit vjetor të hartuara bazuar në planet e mbarështimit të aprovuar.
- Nuk ka përcaktime ligjore se në cilin institucion apo organ do të raportojnë, japin evidencë dhe të dhëna të tjera për administrimin dhe zhvillimin e fondit pyjor në pronësi të qeverisjes vendore.
- Nuk ka të përcaktuar se kujt institucione do ti raportoi të dhënat dhe ndryshimet që ndodhin në fondin pyjor komunal dhe që do të pasqyrohen në kadastrën pyjore.
- Nuk ka mekanizma dhe struktura ligjor të ngutura që të kontrollojnë zbatimin e kërkesave ligjore në përdorimin e pyjeve komunal si dhe mënyrën e raportimit të tyre.
- Nuk ka të shprehur në aktet ligjore që DSHP dhe njësitë e qeverisjes vendore për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor, detyrimisht të kenë të përcaktuar ngarkesën për specialistët që do të mbulojnë administrimin e fondit pyjor dhe kullosor.

- Nuk ka objektiva dhe strategji të qartë deri në çfarë mase do të kalojnë në pronësi të njërive të qeverisjes vendore pyjet dhe kullotat që janë në pronësi të shtetit (DSHP-ve).

Mungesa e hartimit të planeve të mbarështimit të pyjeve pronë shtetërore, si dhe mos zbatimi i planeve të mbarështimit në pyjet komunalë të hartuar, ka bërë që të mos zbatohet parimi i mbarështimit të qëndrueshëm të pyllit i cili nënkupton administrimin dhe përdorimin e tokave pyjore në atë mënyrë dhe në atë shkallë që ato të ruajnë bio diversitetin e tyre, të ruajnë prodhimtarinë , kapacitetin ripërtëritës, vitalitetin si dhe mundësinë për të përmbushur tani dhe në të ardhmen funksione të rëndësishme ekologjike, ekonomike dhe sociale në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë. Në këto plane duhej të pasqyroheshin mbrojtja , trajtimi dhe kryerja e punimeve silvikulturale dhe e punëve të tjera në funksion të mbarështimit të qëndrueshëm të fondit pyjor kombëtar.

Për ndjekjen e zbatimit të planeve të mbarështimit nuk ka një përcaktim ligjor që ngarkon një organizëm ku të jenë përcaktuar funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë në lidhje me zbatimin e planit të menaxhimit të fondit pyjor kombëtar. Parku Kombëtar” Lura” me gjendjen aktuale nuk i përmbush kushtet për të qenë park kombëtar si dhe nuk mbart vlera rekreative dhe turistike për vizitorët.

Për sa më sipër konstatohet se: paketa ligjore që është në fuqi për pyjet dhe kullotat si dhe zonave të mbrojtura nuk i përgjigjet kushteve të reja të krijuara në lidhje me formën e pronësisë dhe të organizimit që kanë pësuar këto pasuri, prandaj mendoj se duhet një rishikim i thellë i paketës ekzistuese apo hartimi i një pakete të re ligjore në veçanti në fushën e pyjeve, kullotave dhe zonave të mbrojtura. paketa ligjore ekzistuese ka mangësi, si dhe ekuivokë në interpretim. Kjo paketë ligjore nuk përcakton qartësisht dhe në mënyrë të hollësishme të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e gjithë

subjekteve juridik dhe fizik që ligji duhet t ngarkoj në administrimin e fondit kombëtar pyjor dhe kullosor si dhe zonave të mbrojtura.

Duke ditur se fondi pyjor dhe kullosor kombëtar, zonat e mbrojtura dhe bio diversitetin e pranishëm janë pasuri kombëtare që i shërbejnë brezave të sotëm dhe të ardhshëm,ku mbrojtja dhe administrimi I tyre duhet të garantojë një zhvillim të qëndrueshëm kjo e shprehur edhe në aktet ligjore dhe nënligjore në zbatim, duhet që:

Auditimet në fushat e administrimit të fondit pyjor kombëtar si dhe kullotave, zonave të mbrojtura dhe bio diversitetit të jenë: auditime të sistemit të menaxhimit si funksionon sistemi; auditime të përputhshmërisë, të performancës dhe auditime të të dhënave mjedisore.

Duhet që të ngrihet një grup pune që të sigurojë, përkthejë dhe përshtatë standardet e serisë ISO 14000, në veçanti ISO 14010, ISO 14011, ISO 14012 si dhe guidat përkatëse që shoqëron këtë seri dhe që kanë të bëjnë me auditimet mjedisore.

---

<sup>i</sup> Botuar në Gazetën “Ekonomia” dt. 27 Prill 2013

<sup>ii</sup> Ky shkrim botohet me disa shkurtime nga origjinali